



VENDIM

Nr. 13 Datë 03.03.2014

**MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË OST SH.A PËR ZGJIDHJEN E
MARRËVESHJEVE PËR PJESËMARRJEN NË TREG, TË
LIDHURA NDËRMJET CEZ TRADE ALBANIA SH.P.K DHE OST
SH.A – OT DHE PËR TËRHEQJEN NGA TREGU I ENERGJISË TË
CEZ TRADE ALBANIA**

Në mbështetje të nenit 12 pika 3, të “Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Treg” miratuar me Vendimin nr. 47, date 04.06.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.03.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “OST” sh.a për zgjidhjen e marrëveshjeve për pjesëmarrjen në treg të lidhura ndërmjet CEZ Trade Albania sh.p.k dhe OST sh.a – OT, përkatësisht atë të nënshkruar në cilësinë e Tregtuesit të Energjisë Elektrike dhe atë të Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Miratimin e Kërkesës së OST sh.a për zgjidhjen e “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg”, të lidhur ndërmjet CEZ Trade Albania sh.p.k në cilësinë e Tregtuesit të Energjisë Elektrike dhe OST sh.a – OT.
2. Miratimin e Kërkesës së OST sh.a zgjidhjen e “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg”, të lidhur ndërmjet CEZ Trade Albania sh.p.k në cilësinë e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike dhe OST sh.a – OT.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.